



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 57, datë 27.11.2020

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË,
BACHELOR NË “FINANCË DHE KONTABILITET”, TË KOLEGJIT UNIVERSITAR
“INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.09.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2020, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “**Financë dhe Kontabilitet**”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në “**Financë dhe Kontabilitet**”
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 566, datë 02.12.2016
- d) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Administrim Biznesi
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite / 6 semestra
- g) Kredite (ECTS): 180 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të “*Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”*” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është “**i përmbush standardet**”.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin Përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Bachelor** në “**Financë dhe Kontabilitet**”, të Kolegjit Universitar “**Instituti Kanadez i Teknologjisë**”, me rekomandimet sipas Shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **6 (gjashtë)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **26/11/2026**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij Vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve Shtetërore të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas Shtojcës bashkëlidhur.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

| | | |
|--------------------|---|---------|
| ARJAN GJONÇA |  | Kryetar |
| ALEXANDER KOHLER |  | Anëtar |
| FABRICE HENARD |  | Anëtar |
| ARBEN MERKOCI |  | Anëtar |
| ALEKSANDËR XHUVANI |  | Anëtar |
| ANILA PAPARISTO |  | Anëtar |
| SULO HADERI |  | Anëtar |
| LULJETA MINXHOZI |  | Anëtar |
| GËZIM VISOKA |  | Anëtar |
| DRINI IMAMI |  | Anëtar |
| FATMIR GURI |  | Anëtar |

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 57, datë 27.11.2020, “Për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, **Bachelor** në “**Financë dhe Kontabilitet**”, të **Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”**, janë si vijon:

1. Institucioni, të mbështesë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit akademik dhe atë ndihmës duke ofruar trajnime profesionale.
2. Institucioni, të rishikojë programet e lëndëve të fushës së financës. Specifikisht, lënda “Metodat e Kërkimit në Financë” të zëvendësohet me një lëndë tjetër sepse nuk përshtatet me programin e ciklit të parë të studimeve si edhe të pasurohen temat e fushës së kontabilitetit dhe raportimit financiar dhe tatimor me njohuri specifike në këto disiplina për realitetin shqiptar.
3. Institucioni, të krijojë mundësi për përfshirjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat do të mundësojnë diversifikimin e burimeve financiare.
4. Institucioni, të institucionalizojë më tej mekanizmat e kontrollit të brendshëm të cilësisë si një instrument për të identifikuar pikat e dobëta dhe mungesat e programit të studimit në mënyrë që t’i përmirësojë në të ardhmen.
5. Institucioni, të rishikojë faqen *on-line* duke bërë të mundur që materialet që postohen të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të korrigjohen disa mospërputhje midis materialeve në dy gjuhët.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

